

Event Rinor Kombëtar “Të rinjtë në veprim! Pjesëmarrja në politikëbërje, fuqizimi ekonomik dhe integrimi social”



Java e Shoqërisë Civile kulmoi me një event kombëtar në Tiranë, me temë “Të rinjtë në veprim - Pjesëmarrja në politikëbërje, fuqizimi ekonomik dhe integrimi social”. Organizuar nga Qendra Kombëtare Burimore, Partnerët Shqipëri, ky aktivitet bëri bashkë mbi 120 të rinj aktivistë dhe organizata rinore nga i gjithë vendi, institucione të qeverisë qendrore dhe vendore, donatore, institucione akademike, përfaqësues nga biznesi, media etj.

I dizenuar si një forum diskutimi mbi politikën rinore dhe sfidat e të rinjve në mbarë vendin, event i shërbeu edhe për promovimin e modeleve të suksesit dhe shkëmbimin e eksperiencave të të rinjve lidhur me përfshirjen në politikëbërje, aktivizmin, fuqizimin ekonomik dhe integrimin social të të rinjve në vend, si dhe krijimin e sinergjisë për rrjetëzim e bashkëpunim në të ardhmen, për të sjellë ndryshime pozitive në shoqëri.



AKTIVITETET E NRC

TË RINJTË NË VEPRIM!

“PJESËMARRJA NË POLITIKËBËRJE, FUQIZIMI EKONOMIK DHE INTEGRIMI SOCIAL”


#TëRinjteNëVeprim



Pjesëmarrja në politikëbërje, fuqizimi ekonomik dhe përfshirja sociale e të rinjve, në fokusin e politikave dhe strategjive në nivel vendor e qendror



Angazhimi në politikëbërje dhe aktivizimi qytetar i të rinjve



Fuqizimi ekonomik i të rinjve përmes punësimit dhe vetëpunësimit



Përfshirja dhe integrimi social i të rinjve

NEWS | ACTUALITET | POLITIKË | EKONOMI | TURIZM | SPORT | BOTA | KULTURË | 11

“Java e shoqërisë civile”, 70 aktivitete në mbi 20 qytete me fokus të rinjtë

Java e Shoqërisë Civile atsh

Prezantimi i raportit vjetor të Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Organizatave të Shoqërisë Civile 2021

Gjatë qershorit 2022, zhvilluam një seri takimesh me OJF-të në mbarë vendin në kuadër të validimit të gjetjeve të raportit vjetor të Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Organizatave të Shoqërisë Civile 2021.


Ndër gjetjet kryesore të raportit përmendim:

- (1) Ligji 80/2021 për regjistrimin e OJF-ve u miratua me reagime dhe kritika të forta nga OJF-të.
- (2) Kodi Penal u ndryshua duke njohur të drejtën e tubimit pa leje (vetëm njoftim) nga policia e shtetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- (3) Pas vitesh diskutime, advokim të sektorit dhe bashkëpunim me institucionet publike përgjegjëse, procedura e rimbursimit të TVSH-së për grantet ka nisur zbatimin me 4 projekte të rimbursuara.
- (4) Po përgatitet Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit, e cila do të kontribuojë në një qasje të bazuar në risk për sektorin e OJF-ve mbi masat për Parandalimin e Pastrimit të Parave / Luftës Kundër Terrorizmit.
- (5) Konsultimet dhe pjesëmarrja e OJF-ve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse mbeten joefektive, pavarësisht nga mekanizmat e bashkëpunimit të vendosur nga qeveria.
- (6) Një sistem i ri faturimi dhe monitorimi i aktiviteteve të të gjithë tatimpaguesve të regjistruar, përfshirë OJF-të, zbatohet prej 2021-it nga autoritetet tatimore shqiptare, duke çuar në fiskalizimin e sektorit.



Gjatë diskutimit me kolegë të shoqërisë civile, në linjë edhe me rekomandimet kryesore të raportit, u theksua nevoja për më shumë transparencë dhe qasje proaktive në ndarjen e informacionit nga institucionet publike, çka do të kontribuonin në mekanizma bashkëpunimi efektive me OJF-të në politikëbërje dhe vendimmarrje, si dhe në procesin e negociatave për anëtarësimin në BE.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu lidhur me nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të OJF-ve, organeve tatimore dhe institucioneve të huaja donatore për zbatimin efektiv të procedurës së rimbursimit të TVSH-së për shpenzimet e aktiviteteve të granteve. Për më shumë mbi gjetjet dhe rekomandimet, [lexoni raportin e plotë](#).



Gjatë prezantimit të gjetjeve të "Matricës së Monitorimit të Mjedisit Mundësues për Shoqërinë Civile – Raporti për Shqipërinë 2021".

Mbi Monitorimin e Udhërrëfyesit për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile

Më datë 22 Qershor 2022 u zhvillua mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile. Si pjesë e takimit, u mbajt një prezantim nga Drejtoria e Përgjithshme e Njësisë së Politikave në Kryeministri (KM) mbi monitorimin e udhërrëfyesit për politikën e qeverisë “Për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile 2019-2023”.

Ndërkohë që vlerësojmë vullnetin e qeverisë për të monitoruar zbatimin e Udhërrëfyesit dhe ndarë rezultatet e monitorimit, theksojmë që:

⇒ Së pari, procesi i monitorimit nuk është realizuar në bashkëpunim, me kontributin dhe përfshirjen në shkallë vendi të organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve), sikurse parashikon Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 539, datë 25.7.2019.

⇒ Së dyti, nga prezantimi rezulton se tre prioritetet strategjike janë realizuar në përqindje të konsiderueshme, respektivisht:

Drejtimi Strategjik 1 “Bashkëpunimi i institucionalizuar Qeveri-Shoqëri Civile në politikëbërje dhe në Integrimin Evropian” në masën 85%;

Drejtimi strategjik 2 “Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave” në masën 64%;

Drejtimi strategjik 3 “Kuangër fiskal dhe financues i favorshëm” në masën 63%;

ndërkohë që në të gjitha raportimet e viteve të fundit mbi monitorimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile është theksuar që nuk ka ose ka shumë pak progres në drejtim të zbatimit të udhërrëfyesit.

⇒ Së treti, mënyra e prezantimit duke u fokusuar në % (përqindje) të realizimit të masave dhe jo në tregues konkret që reflektojnë progresin, nuk ofron transparencën e duhur lidhur me këtë monitorim. Nuk ka asnjë informacion publik si është bërë vlerësimi i këtij progresi dhe cilat janë evidencat për realizimin e masave dhe indikatorëve.

Për më shumë, gjeni në vijim:

- [Lajmin e plotë](#)
- [Tabelë përmbledhëse](#) të realizimit të masave prezantuar nga përfaqësuesit e qeverisë, si dhe komentet tona respektivisht, bazuar në monitorimin e mjedisit mundësues për shoqërinë civile
- [Prezantimin](#) e mbajtur në mbledhjen e KSHHC-së

Duke vlerësuar rëndësinë e zbatimit të udhërrëfyesit dhe të një procesi periodik monitorimi në bashkëpunim, me kontributin dhe përfshirjen në shkallë vendi të OSHC-ve, ftojmë institucionet përgjegjëse të jenë më transparente në ndarjen e informacionit mbi këtë proces dhe aktorët e përfshirë në të, si dhe në ndarjen e një raporti të plotë dhe të detajuar lidhur me realizimin e masave.



Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri

Pas dy vitesh përpjekje advokimi të Grupimit të OJF-ve që punojnë me vullnetarizmin, nën udhëheqjen dhe lehtësimin e Qendrës Kombëtare Burimore dhe Përtej Barrierave, ka patur një ndërgjegjësim nga ana e institucioneve përgjegjëse për këtë çështje.

Duke njohur problematikat në legjislacion dhe sfidat në zbatimin e tij, me iniciativë të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në prill 2022 u krijua një grup pune i përbashkët me përfaqësues nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile pjesë e Grupimit, për të diskutuar mbi këto problematika dhe dhënë rekomandime për ndryshime në Ligj. Grupi i punës ka organizuar vetëm një takim të parë prezantues, gjatë të cilit OSHC-të theksuan edhe njëherë nevojën për rishikim tërësor të ligjit duke qenë se nuk i shërben nxitjes së vullnetarizmit në vend dhe krijimit të një mjedisi mundësues për zhvillimin e mëtejshëm të tij. Për krijimin e këtij Grupi Pune dhe rishikimin e Ligjit është dërguar një njoftim edhe pranë Kuvendit të Shqipërisë, drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, duke qenë se në muajt e kaluar ka patur diskutime në Komision rreth situatës me zbatimin e ligjit dhe sfidat në këtë drejtim. Për më shumë rreth takimeve të ardhshme dhe të rejave mbi këtë çështje na ndiqni në:



resourcecentre.al



[resourcecentrealbania](https://www.instagram.com/resourcecentrealbania)



<http://www.resourcecentre.al/>


Help desk

Shërbim Ligjor për OJF-të

Informim dhe Edukim Ligjor për OJF-të

Këshillim Ligjor në lidhje me krijimin, funksionimin, përputhshmërinë ligjore dhe fiskale, dhe çregjistrimin ligjor për OJF:

resourcecentre.al [resourcecentrealbania](https://www.instagram.com/resourcecentrealbania) <https://resourcecentre.al> 0697889600



Shërbimi ligjor për organizatat e shoqërisë civile

Edhe përgjatë këtyre muajve, Qendra Kombëtare Burimore ka vijuar me ofrimin e shërbimit ligjor për OJF-të dhe aktivistët e shoqërisë civile.

23 organizata janë asistuar kryesisht mbi çështje që lidhen me ndryshime në

dokumenta themelues të organizatës në përshtatje me dinamika të reja zhvillimore si ngritja e shërbimeve me pagesë, hapja e degëve të reja apo shkëputja nga organizata themeluese mëmë, etj., por gjithashtu dhe aspekte procedurale mbi procedurat e rimbursimit të TVSH-së, regjistrimit të pronarëve përfutues, manaxhimi dhe shitja e asetëve të OJF-ve, regjistrimi i biznesit social, procedura për t'u ndjekur në rast shkelje të së drejtës së privatësisë së target-grupit më të cilin organizata punon, sfida kontraktuale me institucione vendore si pasojë e ndryshimit të legjislacionit mbi prokurimin e shërbimeve sociale etj. Edhe përgjatë këtyre muajve, iu është ofruar asistencë ligjore aktivistëve dhe grupimeve informale mbi hapat ligjorë në themelimin dhe regjistrimin e një organizata jo-fitimprurëse. Për më shumë informacion mbi shërbimin ligjor dhe si të përfitonin prej tij, lexoni [këtu](#).

AKTIVITETET E NRC

Aktivite nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri



Enela Mone dhe Arbana Dibra, koordinatore të zyrave rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore në Shkodër dhe Vlorë, duke prezantuar aktivitetin dhe shërbimet e Qendrës Burimore për periudhën 2022-2025, në Radiot Lokale "Valë e Kaltër" 103.3 FM dhe Radio "Jehona" FM 107.6 Mhz.



Gjatë prezantimit të punës dhe programave të Qendrës Burimore në rajone të ndryshme të vendit - Zyra rajonale Vlorë dhe Shkodër në Java e Evropës 2022.



Gjatë sesionit informues dhe ndarjes së praktikave mbi "Këshillimi i karrierës rruga drejt punësimit rinor" me nxënës të shkollave të mesme "Oso Kuka" Shkodër & "Qemal Ataturk" Vlorë - Aktivite nga zyrat rajonale të Qendrës Burimore në kuadër të Javës së Shoqërisë Civile 2022



Gjatë forumit të hapur me studentët e Universitetit Luigj Gurakuqi për nxitjen e vullnetarizmit dhe mundësitë që ofron programi Erasmus Plus për të rinjtë në Universitete - Zyra Rajonale Shkodër

Kodi i Standardeve


për organizatat jofitimprurëse në Shqipëri

Anëtarësia e Kodit vazhdon të zgjerohet me anëtarë të rinj! Muajtë e fundit, Qendra psiko - sociale "Vatra", COSV në Shqipëri, Forumi i Gruas Elbasan, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën - (SHKEJ) dhe Fondacionin "Fryma e Dashurisë" – Diakonia Agapes i janë bashkuar Kodit të Standardeve për OJF-të në Shqipëri.

Në takimet e komitetit gjatë katër muajve, janë vlerësuar shprehjet e reja të interesit për anëtarësim në Kod. Disa organizata janë ende në proces.

Qendra Burimore, në cilësinë e Sekretariatit të Kodit të Standardeve për OJF-të, ka vijuar gjatë kësaj periudhe promovimin e Kodit të Standardeve si një mekanizëm që u shërben organizatave për rritjen e standardeve të veprimtarisë së tyre dhe qendrueshmërisë. Në të njëjtën kohë, është ofruar informacion dhe asistencë për të gjitha organizatat e interesuara për të u anëtarësuar në Kod.

Bëhuni dhe Ju anëtarë të Kodit! Procesi i anëtarësimit është i hapur në çdo kohë! Dërgoni shprehjen e interesit dhe dokumentacionin e nevojshëm në platformën standards4npo.al! Për më shumë informacion dhe pyetje na shkruani në info@resourcecentre.al ose na vizitoni në zyrat tona në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë!






AKTIVITETET E NRC

Nga retorika në veprim – Mbi Dinamikat në Përgjegjshmërinë e OSHC-ve

Përgjatë datave 23-26 maj 2022, Accountable Now organizoi eventin "Rrugëtime të Përgjegjshmërisë" si pjesë e Komunitetit të Praktikave mbi Dinamikat në Përgjegjshmërinë e Organizatave të Shoqërisë Civile – iniciativë e Global Standard, CIVICUS, dhe Restless Development.

Takimi ofroi një hapësirë diskutimi për pjesëmarrës nga mbarë bota, mbi aspekte të ndryshme të zhvillimit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në organizatat e tyre si dhe ndarjen e praktikave të mira në drejtim të gjithëpërfshirjes dhe diversitetit, përshkallëzimit të impaktit të

OSHC-ve përmes mjeteve dixhitale, kalimit nga diskutimi në veprim për më shumë përgjegjshëri dhe transparencë etj. [Për më shumë link](#)




E ftuar si pjesë e panelit "Rrugëtime tona të përgjegjshmërisë", Ariola Agolli, Menaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore, Partnerët Shqipëri ndau përvojën mbi praktikën e Kodit të Standardeve për OJF-të në Shqipëri duke evidentuar rëndësinë e një procesi pjesëmarrës e me përfshirje të gjerë të përgatitjes të Kodit, parimet dhe angazhimet kryesore të Kodit, sfidat e procesit si dhe mundësitë që ofron Kodi si një mekanizëm vet-rregullues për avancimin e standardeve dhe rritjen e përgjegjshmërisë në sektor.

Programi i Akademisë së OJF-ve 2022 ka vijuar gjatë këtyre muajve me leksionet mbi [Menaxhimi dhe Zhvillimi Organizativ](#); [Menaxhimi Financiar](#); dhe [Planifikimi Strategjik](#).




[Menaxhimi dhe Zhvillimi Organizativ](#)

#Leksioni3 u fokusua në strukturat qeverisëse të OSHC-ve, rolet, përgjegjësitë, politikat, procedurat dhe sfidat në menaxhimin organizativ.





Leksioni u drejtua nga Ilina Neshikj, me një përvojë të gjatë profesionale që përfshin koordinimin e rrjetit global të OJF-ve Accountable Now, Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, BCSDN, një rrjet rajonal prej 14 OSHC-ve në Ballkan dhe Turqi, dhe së fundmi, Unioni për Liritë Civile për Evropën. Ekspertiza e saj përfshin çështje të zhvillimit të shoqërisë civile, qëndrueshmërinë e OSHC-ve, përgjegjshmërinë kundrejt komunikimit strategjik dhe advokimit.



[Menaxhimi Financiar](#)

#Leksioni4 u fokusua në konceptet kryesore të Menaxhimit dhe Kontrollit Financiar dhe rëndësinë e tyre në menaxhimin organizativ, format e raportimit financiar, standardet e kontabilitetit dhe detyrimet ligjore për raportimet në shtet, buxhetimin etj.



Leksioni u drejtua nga Jetmira Hysenaj Menaxhere

Finance pranë Partnerëve Shqipëri dhe Fjoralba Balla, Oficere Financiare. Jetmira dhe Fjoralba kanë mbi 17 vjet përvojë pune secila në sektorin financiar dhe jofitimprurës, me ekspertizë të gjerë në disa drejtime si: planifikim dhe analizë financiare, kontabilitet, taksa, manaxhim grantesh, kontroll financiar, etj. si dhe në dizajnimin dhe ofrimin e programeve të rritjes së kapaciteteve financiare për sektorin jofitimprurës dhe fitimprurës.



[Planifikimi Strategjik](#)

#Leksioni5 Leksioni u fokusua në ciklin e planifikimit strategjik, rolin dhe rëndësinë e planifikimit strategjik për organizatën etj.



Leksioni u drejtua nga Gentiana Murati Kapo - Menaxhere e granteve dhe Eksperte për zhvillimin e kapaciteteve në Rrjetin e Grave të Kosovës (RrGK). Gentiana vjen me një eksperiencë prej 10 vitesh në mbështetjen e zhvillimit të OSHC-ve në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor përmes mentorimit dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre, veçanërisht në ndërmarrjen e iniciativave efektive të avokimit, menaxhimin e ciklit të projektit, menaxhimin organizativ dhe menaxhimin financiar.



Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë

Paralelisht me zhvillimin e leksioneve, si pjesë e programit janë zhvilluar me akademistët dhe seancat e mentorimit, duke u fokusuar në aspekte të caktuara të praktikave të brendshme organizative bazuar në standardet e përgjegjshmërisë së sektorit jofitimprurës si llogaridhënia, transparenca, proceset vendimmarrëse dhe praktika të tjera organizative.


Programet Trajnimi për OSHC-të

Këtë vit komponenti i forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve vjen me programe të reja në mbështetje të sektorit, për të adresuar nevojat e identifikuar nga Qendra Burimore përgjatë punës së saj me sektorin, por edhe kërkesa specifike të OSHC-ve për çështje me interes.

1 Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet

Dizenuar si një program afatgjatë trajnimi dhe mentorimi, programi u vjen në ndihmë organizatave të interesuara në zhvillimin e strategjive dhe planeve në ngritjen e fondeve dhe gjenerimin e të ardhurave nga produkte dhe shërbime konkrete me pagesë. Në këtë mënyrë, duke diversifikuar burimet e financimit të aktivitetit të tyre, OSHC-të rrisin edhe qendrueshmërinë financiare si dhe pavarësinë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, në veçanti lidhur me punën advokuese me institucionet në nivel vendor dhe qendror.

Pas një thirrje të hapur për shprehje interesi, 17 përfaqësues të OSHC-ve nga Shkodra, Pogradeci, Durrësi, Librazhdi, Vlora, Gjirokastra dhe Tirana u bënë pjesë e programit të këtij viti. Identifikimi i produkteve/shërbimeve me pagesë nga OJF-të, përcaktimi i modelit të biznesit si dhe analiza e tregut ishin disa nga çështjet e trajtuara përgjatë 2 moduleve të para. Paralelisht me modulet, nëpërmjet mentorimeve organizatat janë mbështetur për të analizuar gatishmërinë e tyre në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve me pagesë, kapacitetin organizativ, si dhe mundësitë që ofron tregu vendas, rajonal e më gjerë.




Gjatë programit të trajnimit – "Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet"

2 Manaxhimi dhe monitorimi i granteve

Manaxhimi dhe monitorimi i granteve është një tjetër program i ri dizenuar nga Qendra Kombëtare Burimore, dedikuar rritjes së kapaciteteve të organizatave të cilat e kanë nën-grantimin (mbështetjen financiare për OSHC të tjera) pjesë të programeve aktuale apo të cilat synojnë të rrisin kapacitetet në këtë drejtim për të ardhmen.


16 organizata nga Tirana dhe Shkodra morën pjesë në programin e parë me këtë temë dhe rritën njohuritë e tyre mbi çështje si: hartimi dhe lançimi i thirrjes për propozime, procedura e vlerësimit dhe kontraktimi, krijimi i ekipit të manaxhimit të projektit, përgatitja e thirrjes për propozime, publikimi dhe promovimi i thirrjes për propozime, dorëzimi dhe regjistrimi i aplikimeve, vlerësimi i aplikimeve. Për të gjithë të interesuarit mbi këtë temë na kontaktoni në info@resourcecentre.al për tu bërë pjesë në vijimësi.



Gjatë programit të trajnimit – "Manaxhimi dhe monitorimi i granteve"

Nisur nga interesi i OSHC-ve rreth programeve të Bashkimit Evropian mbi zhvillimin e vullnetarizmit, kryesisht mbi European Solidarity Corps, Qendra Burimore zhvilloi përgjatë muajve maj - qershor 2022, programe rajonale trajnimi në Shkodër dhe në Vlorë. Me pjesëmarrjen e 35 përfaqësuesëve OSHC-së nga [Shkodra](#), [Fushë-Arrëzi](#), [Lezha](#), [Vlora](#), [Gjirokastra](#) dhe [Selenica](#). Pjesëmarrësit gjatë trajnimeve patën mundësi të rrisin njohuritë e tyre mbi programet e BE-së mbi vullnetarizmin dhe procesin e aplikimit për akreditim (Label Quality) për t'u bërë pjesë e këtyre programeve në nivel Evropian. Për të gjitha OJF-të që dëshirojnë të bëhen pjesë në programin e ardhshëm rajonal të trajnimit në Tiranë, mund të na kontaktoni në info@resourcecentre.al brenda datës 8 shtator 2022.

3 "Vullnetarizmi dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në Programet e BE"



Java e Evropës 2022

Gjatë datave 3-12 maj, Delegacioni i Bashkimit Evropian organizoi Javën e Evropës 2022 në një format ndryshe këtë vit. Programi përmbante një seri aktivitetesh, takimesh e eventesh shkëmbimi me pjesëmarrjen e gjerë të qytetarëve dhe komuniteteve lokale, institucioneve qeveritare, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve të tjerë, në një seri panairësh nga Veriu në Jug të vendit.

Në kuadër të aktiviteteve të Javës së Evropës, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe dy Zyrat rajonale në Shkodër dhe Vlorë, ishin pjesë e panairëve organizuar nga Europe House në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, për të prezantuar punën e Qendrës, programin për grupe të ndryshme interesi, si dhe kontributin e deritanishëm dhe rolin që Qendra luan në sektor.



Tiranë



Vlorë



Shkodër


Java e Demokracisë Vendore 2022

LëvizAlbania organizoi për të gjashtin vit radhazi Javën e Demokracisë Vendore në Shqipëri.

Një aktivitet i kthyer tashmë në traditë në të cilin qytetarët dhe zëri i tyre kulmon së bashku me rolin qytetar për një demokraci vendore funksionale dhe të fortë.

#JDV2022 u mbajt përgjatë datave 6 - 11 Qershor dhe aktivitetet u fokusuan në tre tematika kryesore: (1) Individët si aktorë ndryshimi; (2) Të bashkuar jemi më të fortë dhe (3) Ndryshimi është i mundshëm. Ballafaqimi i sfidave dhe nevojave që ka mjedisi dhe komunitetet vendore për tu angazhuar, kërkuar dhe arritur ndryshimin e situatës qoftë për nivelin e demokracisë vendore po ashtu edhe për cilësinë e qeverisjes vendore, ishin kryefjala e diskutimeve përgjatë JDV2022.

[Lexoni më shumë](#)



Java Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë - IDAHOT 2022 në Shqipëri

Edhe këtë vit, në kuadër të IDAHOT në Shqipëri përgjatë muajt maj 2022, u organizua java Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë. Aktivistët shqiptarë të LGBTIQ nga Aleanca LGBT, Pro LGBT, Streha, Open Mind Spectrum Albania dhe Pink Embassy organizuan një seri aktivitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit kundër dhunës dhe diskriminimit ndaj personave LGBTI.

[Lexo më shumë](#)



Deklaratë e përbashkët nga Organizatat Mjedisore në Shqipëri për gjendjen mjedisore në vend

Në datën 5 maj 2022, si pjesë e 'Forumit Mjedisor', një grupim i gjerë organizatash mjedisore, aktivistë dhe ekspertë, diskutuan mbi ndryshimet klimatike dhe energjinë, ndotjen e mjedisve urbane dhe natyrore dhe promovimin e mbrojtjen e habitateve.

Pjesëmarrësit në Forum dolën me një deklaratë të përbashkët përmes së cilës shprehën publikisht shqetësimin mbi masat, politikat dhe investimet të cilat po ndikojnë në degradimin e gjendjes mjedisore në vend. [Lexo më shumë](#)





Mbrojtësit e të drejtave të njeriut për vitin 2022

Aktivistët LGBTI+ dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut Frank Mugisha nga Uganda dhe Xheni Karaj nga Shqipëria janë nderuar me Çmimin Civil Rights Defenders of the Year 2022. Pavarësisht kërcënimeve, ngacmimeve dhe rrezikut për sigurinë e tyre, marrësit e çmimeve vazhdojnë të punojnë për të drejtën e çdo individi për të pasur orientimin e vet seksual apo identitetin gjinor. Të dy aktivistët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e lëvizjeve LGBTI+ në vendet e tyre dhe kanë frymëzuar aktivistë LGBTI+ në të gjithë rajonin e Ballkanit dhe kontinentin afrikan. Ky çmim ndahet çdo vit nga Civil Rights Defenders për punë të jashtëzakonshme në mbrojtje të të drejtave civile dhe politike. [Lexo më shumë këtu.](#)



ALBANIA Indicators on the Level of Media Freedom and Journalists' Safety in Albania 2021

Raporti i Rrjetit Safe Journalists: Treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Shqipëri

Më datë 22 qershor 2022, Rrjeti Safe Journalists organizoi një event online mbi prezantimin e "Raporti 2021 i Safe Journalists Network Liria dhe Siguria e Gazetarëve në Shqipëri". Ky është raporti i dytë për Shqipërinë, zhvilluar me një metodologji rigorozë dhe në linjë me raportet që prej 7 vitesh Rrjeti publikon për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacinë me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Për më shumë, gjeni raportin e [plotë këtu](#)



Tryezë diskutimi mbi Vlerësimin e Riskut të Sektorit të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit


Pas një procesi njëvjeçar, Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbështetjen nga GIZ, në datën 17 qershor 2022, zhvilluan një tryezë mbi gjetjet paraprake të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Sektorit të OJF-ve ndaj Financimit të Terrorizmit (FT). Gjetja kryesore e Raportit, bazuar në analizën e të dhënave dhe informacioneve të marra nga institucionet shtetërore, sektori financiar, OJF-të, komunitetet fetare dhe raportet ndërkombëtare, ishte se "sektori i OJF-ve paraqitet me nivel të ulët rrishtu ndaj FT".



Rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në mënyrë që sektori i OJF-ve të mos klasifikohet i gjithi si me nivel të lartë rrishtu ndaj financimit të terrorizmit, por të pasqyrojë kategorizimin e sektorit sipas vlerësimeve reale të kryera në përputhje me kërkesat e metodologjisë së FATF, ishte rekomandimi kryesor dhe gjeti përkrahjen e pjesëmarrësve në tryezë dhe angazhimin për zbatim si pjesë e një procesi bashkëpunues midis gjithë aktorëve.

Deklarata e BCSDN-së mbi "Udhëzuesi i BE për mbështetjen e shoqërisë civile për vendet e zgjerimit"

Ndër vite, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) ka ndjekur qasjen e BE-së në mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit duke advokuar që shoqëria civile të njihet dhe të mbështetet në mënyrë adekuate si një partner kompetent në procesin e zgjerimit të BE-së.



Duke vlerësuar rëndësinë që ka Udhëzuesi i BE për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, në vendosjen e objektivave zhvillimorë për shoqërinë civile në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, si dhe procesin e gjatë që ka marrë përgatitja e Udhëzuesit të ri 2021-2027, në maj 2022, BCSDN doli me një deklaratë publike drejtuar DG NEAR dhe aktorëve të tjerë të përfshirë, duke kërkuar publikimin dhe miratimin e Udhëzuesit të ri 2021-2027 pa vonesë të mëtejshme, duke përfshirë treguesit mbi bazën e të cilave çdo vend do të mund të monitorohet dhe vlerësohet për zbatimin e tyre. [Gjeni këtu deklaratën e plotë](#)

TACSO 3 - Forumi Rajonal i shoqërisë civile për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2022

Më 8-9 qershor 2022, TACSO 3 organizoi në Shkup Forumin e OSHC-ve për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Forumi solli bashkë OSHC nga Maqedonia e Veriut, Bosnia dhe Hercegovina, Mal i Zi, Kosova, Serbia, Shqipëria dhe Turqia, përfaqësues të lartë të Komisionit Evropian DG NEAR dhe Delegationëve të BE-së në rajon, institucione shtetërore dhe donatorë, në një hapësirë të hapur diskutimi mbi një sërë çështjesh me rëndësi për sektorin si e ardhmja e mjedisit mundësues për shoqërinë civile, bashkëpunimi Shtet-OSHC, Agjenda e Gjellbër, Shteti i së Drejtës, bashkëpunimi Media-OSHC etj.



Në qendër të diskutimeve të Forumit ishte [Udhëzuesi i rishikuar për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për vendet e zgjerimit, 2021-2027](#), i cili u prezantua në Forum. Për më shumë mbi Forumin lexoni [këtu](#)





Workshop Rajonal “Veprimi i Përbashkët për Promovimin e Hapësirës Qytetare dhe një Shoqërie Civile më të adaptueshme”


Gjatë datave 30 dhe 31 maj 2022, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) organizoi në Beograd workshopin rajonal “Veprimi i Përbashkët për Promovimin e Hapësirës Qytetare dhe një Shoqërie Civile më të adaptueshme”. Workshopi u ndoq nga organizata të shoqërisë civile dhe rrjete, donatorë, organizata ndërkombëtare, aktivistë qytetarë, gazetarë dhe aktorë të tjerë, duke diskutuar qasjet inovative dhe të përgjegjshme të advokimit për rritjen e rolit të shoqërisë civile në nivel kombëtar, rajonal dhe të Bashkimit Evropian. [Lexo më shumë](#)

Forume Rajonale mbi Ndikimin e Covid-19 në Ballkanin Perëndimor

Qendrat Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në vendet e rajonit prej disa muajsh tashmë janë angazhuar në një iniciativë të përbashkët ndërmarrë nga Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me Macedonian Center for International Cooperation, Center for Civic Initiatives, Centre for Development of Non-Governmental Organizations, Civic Initiatives dhe Kosovar Civil Society Foundation për nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të një mjedisi më mundësues dhe mbështetës në kuadër të situatës pandemike të COVID-19 dhe adaptimit me të. Iniciativa mbështetet nga Balkan Trust for Democracy një projekt i German Marshall Fund i Shteteve të Bashkuara dhe USAID-it.

Gjatë muajve prill-qershor janë organizuar tre forume të tjera rajonale, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OSHC-ve, rrjeteve rajonale, organizatave ndërkombëtare, institucioneve shtetërore, akademike, biznesit e medias.


Forumi “**Aksesi në shërbime gjatë pandemisë COVID-19 me fokus të veçantë aksesin e grupeve të marginalizuara**” organizuar më 29 prill 2022 nga Qendra Burimore për Shoqërinë Civile Kosovë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, solli përmes diskutimeve një panoramë të gjendjes së aksesit në shërbime për grupet e marginalizuara gjatë pandemisë COVID-19, duke theksuar rolin e palëve të interesuara. Si pjesë e Forumit, OSHC-të ndanë një seri praktikash të mira në lidhje me shërbimet për grupet në nevojë. [Lexo me shumë](#)



Forumi “**Roli i një mjedisi mundësues në nxitjen e filantropisë dhe solidaritetit në kohë krizash**” organizuar më 26 maj, 2022 nga Qendra Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Partnerët Shqipëri, u fokusua në rolin e filantropisë gjatë kohës së pandemisë, duke theksuar aspektet ligjore të mundësitë të një aktiviteti të tillë dhe shkëmbimin e praktikave të mira të filantropisë dhe solidaritetit. Në përfundim një set rekomandimesh për një reagim të koordinuar dhe të përmirësuar u hartua bazuar në diskutimet përgjatë forumit. [Lexo me shumë](#)



Forumi “**Adaptueshmëria e të rinjve dhe organizatave rinore gjatë pandemisë COVID-19**” organizuar më 24 qershor 2022, nga Qendra Burimore për Shoqërinë Civile në Bosnje Hercegovinë, Qendra për Iniciativa Qytetare, pati në fokus të diskutimeve rininë dhe organizatat rinore. Impakti i pandemisë tek të rinjtë, politikat dhe masat për minimizimin e pasojave, qëndrueshmëria e organizatave rinore dhe roli i tyre gjatë kohës së pandemisë ishin disa nga çështjet e trajtuara gjatë forumit. Pjesëmarrësit gjithashtu ndanë disa praktika të mira nga OSHC-të dhe rrjetet rinore.



Thirrje për shprehje interesi

Programi i asistencës

Për rrjetet, koalicionet dhe grupimet e organizatave të shoqërisë civile

APLIKO TANI

hapur

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Kreu Rreth Programit Praktika e punës Institucionet Aplikimi Kontakt

Zbulo veten tënde, bëhu pjesë e diçkaje më të madhe!

Jepi Vetes mundësinë të përfutur përvojë pune pranë institucioneve publike dhe private.

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës
Thirrja është e Programit është një mundësi për të gjithë të rritur nga 21 deri në 26 vjeç, të cilët kurrë nuk kanë përfunduar ministratë civile e parte të shtesme "shkollore" dhe nuk kanë qenë pjesë e programit të thirrjeve mëparshme.

Zbulo pozicionet Apliko tani

hapur

Home About Us News Information Centre Contact

CALL FOR APPLICATIONS FOR STRATEGIC MEDIA PARTNERS

Public Calls 24 Jun 22

hapur

WB6 MEDIA: Support to Media Freedom and Pluralism in the Western Balkans

Njoftimi paraprak mbi ndryshimin e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Ministria e Drejtësisë | Postuar më: 27.06.2022 | Data e Shkëlqimit: 30.07.2022 | Statusi: Konsultë hapur

hapur

Projektligji "Për tatinin mbi të ardhurat"

Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Postuar më: 16.06.2022 | Data e Shkëlqimit: 16.07.2022 | Statusi: Konsultë hapur

mbyllur

EURO-MEDITERRANEAN CO-CREATION RESIDENCY PROGRAMME

hapur

amshc

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

THIRRJA NR. 15

(31.05.2022 - 01.07.2022)

PER PROJEKT -PROPOZIME

mbyllur

Being Accountable:

Our different journeys towards inclusiveness, diversity and shifting power

AUGUST 30th 2022 // 14.00PM CEST

hapur

A CHANCE FOR CHANGE

CHANGE

DEMOCRACY COMMISSION SMALL GRANTS PROGRAM

PROPOSALS SUBMISSION DEADLINE

June 17, 2022

mbyllur

THIRRJE DHE MUNDËSI

KALENDAR TREMUJOR

Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!

Korrik 2022						
S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

Gusht 2022						
S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Shtator 2022						
S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		



Akademia e OJF-ve



Trajime dhe Seminare për OShC-të



Aktivitete rrjetëzimi



Forume Publike dhe Evente

NA KONTAKTONI :

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë

(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim")
Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr. Oso Kuka, Kati i 2të, Hyrja 1, Shkoder (në mjediset e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim")

E-mail: shkodra@resourcecenter.al


Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë

(në mjediset e Qendrës "Aulona")
Tel: +355 3 3224531

E-mail: vlor@resourcecenter.al

NA NDIQNI :  [resourcecentre.al](https://www.facebook.com/resourcecentre.al)

 [resourcecentrealbania](https://www.instagram.com/resourcecentrealbania)

 [resourceCSO al](https://twitter.com/resourceCSO)

 [ResourceCentreAlbania](https://www.youtube.com/ResourceCentreAlbania)

 <http://www.resourcecentre.al/>

 [National Resource Centre for Civil Society in Albania](https://www.linkedin.com/company/national-resource-centre-for-civil-society-in-albania)